



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave

Datë 20.06.2025

RAPORT VENDIMMARRJEJE

Projekt-vendimin (titulli i projektvendimit): **PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDEVE TË TRASHËGUARA NGA VITI 2024.**

Baza ligjore:

Ligji nr.139 dt.17/12/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligji nr. 9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, “Udhëzimi i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarte të Zbatimit të Buxhetit”, Udhëzim Plotësues të Ministrit të Financave nr.2 dt.24/01/2025 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025”, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Buxhetit në bashkëpunim me Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS)”.

Propozimi nga kryetari/këshilltarët/tjetër (Çfarë propozohet në projektvendim):

Kryetari i bashkisë, sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Buxhetit në bashkëpunim me Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS) i propozon Këshillit Bashkiak të shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore dhe të vendosë:

1. Miratimin e përdorimit të fondeve të trashëguara nga viti 2024 prej lekë 1,044,179,434 lekë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	EMËRTIMI I LLOGARISË	Totali	Burimi i financimit		
			Transferta sektoriale (kapitull 1)	Transferta e pakushtëzuar (kapitull 1)	Të ardhurat (kapitull 5)
1	Shpenzime Personeli (600-601)	25,543,591	25,543,591	-	-
2	Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651)	123,684,269	11,541,554	54,893,542	57,249,173
3	Shpenzime Kapitale të Brendshme (230-232, 255, 1661)	894,951,574	43,036,996	204,758,267	647,156,311
4	Shpenzime Kapitale të Huaja (230-232)	-	-	-	-
TOTALI		1,044,179,434	80,122,141	259,651,809	704,405,484

- 1.1 Të miratojë përdorimin e fondeve të trashëguara nga viti 2024, për çdo program buxhetor sipas pasqyrës nr.1.
- 1.2 Të miratojë përdorimin e fondeve të trashëguara nga viti 2024 sipa burimit të financimit sipas pasyrave nr.1.1, 1.2 dhe 1.3.
- 1.3 Të miratojë përdorimin e fondeve të trashëguara nga viti 2024 për shpenzime kapitale sipas pasqyrës nr.2.

Analiza Financiare/ Buxheti total/natyra e financimit (të ardhurat e veta, transferta etj):

Fondet e trashëguara nga viti 2024 (nga të ardhurat e veta, transeferte e pakushtëzuar + transferte sektoriale) dhe fonde nga taksat dhe tarifat e arkëtuara dhe të papërdorura në vitin 2024.

Drejtoria/Sektori përgjegjës që ka përgatitur materialin:

Drejtoria e Buxhetit në bashkëpunim me Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS).

Impakti social/grupet që preken:

Banorët e Bashkisë Durrës.

A është objekt konsultimi: (PO/JO)

JO.

Komisioni i përhershëm/përkohshëm i Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave, u mbledhë më datë 20.06.2025, dhe shqyrtoi pikën nr. 2 të rendit të ditës, relacionin dhe dokumentat shoqërues të tij.

Komunikimi midis administratës dhe komisionit i përhershëm/përkohshëm:

Në varësi të relacionit të paraprirur Komisioni u dakordëzua për ta kaluar në votim pikën 2 të rendit të ditës mbledhje të përbashkët Bashkiak Durrës jo datë 23/06/2025.

Për sa më sipër, pas shqyrtimit, të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese, Komisioni me shumicë votash, vendosi:

T'i propozojnë Këshillit Bashkiak:

- a- Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim
- b- Miratimin e projekt aktit
- c- Refuzimin e miratimit të projektaktit
- d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si vijon:
- e- _____

Komisioni i Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave

Kryetar Rolant Xhelilaj

Zv/Kryetar Erzen Laçi

Sekretar Hekuran Markola

Anëtar Jonada Mamo

Anëtar Alfred Mullaraj

Anëtar Denisa Luarasi

Anëtar Silvana Agasi

Anëtar Dritan Burgija

Anëtar Jonuz Myshketa

Anëtar Xhojana Gjineci

Anëtar Kontjana Kuçi